

KOMITETI SHTETËROR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN (KSHIE)

Drejtohet nga Kryeministri dhe në të marrin pjesë:
a) Kryetari i Delegacionit Shtetëror;
b) Kryenegociatori;
c) Ministrat përgjegjës për çështjet e brendshme, të ekonomisë, financës dhe drejtësisë;
ç) Sekretari i Përgjithshëm i KM
Sipas tematikës marrin pjesë kryetare të Institucioneve të pavarura dhe Ministri përgjegjës sipas tematikës së diskutimit

Funksionet:
a) Siguron mbikëqyrjen e strukturës së negociatave
b) Bashkërendimin e qëndrimit negociues për secilin kapitull të acquis, përpara miratimit nga Këshilli i Ministrave
c) Orienton ministrin që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë shtetërore për kapitullin përkatës të acquis dhe Kryenegociatorin për propozimin për qëndrimin negociues që do t'i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

DELEGACIONI SHTETËROR

Përbëhet nga:
a) Ministri përgjegjës për punët e jashtme, në funksionin e kryetarit;
b) Kryenegociatori, në funksionin e zëvendëskryetarit;
c) Kreu i Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian;
ç) Përfaqësues të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore

Funksionet:
a) Përgjegjës për zhvillimin e dialogut politik dhe të negociatave me institucionet e BE, përfshirë hapjen dhe mbylljen e negociatave për secilin kapitull të acquis të BE.
b) Përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe vepron në përputhje me qëndrimet negociuese të miratuara prej tij, sipas përcaktimit të pikës 6, të kreut III, të këtij vendimi.
c) Përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Konferencën Ndërqeveritare Shqipëri- BE, në kuadër të negociatave të aderimit në BE.

GRUPI NEGOCIATOR

Përbëhet nga:
a) Kryenegociatori
b) Jo me pak se 7 anëtarë

Funksionet:
- Zhvillon procesin e diskutimeve dhe negociatave për çdo kapitull të acquis, sipas qëndrimeve negociuese të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- Diskuton, vlerëson, monitoron dhe bashkërendon, raporton, përditëson mbi procesin e zbatimit të MSA
- Raporton në KSHIE në kuadër të procesit të Integrimit Evropian, etj.

PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Përbëhet nga:
a) Pjesëmarrja e shoqërisë civile,
b) Grupeve të interesit,
c) Biznesit,
d) Sindikatave,
e) Botës akademike,
f) Organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore
Miratohet me Urdher të Kryeministrit.

Funksionet:
Informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, sindikatave, botës akademike dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe në procesin e stabilizim-asociimit realizohen nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimit Evropian.

MISIONI I SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Funksionet:
a) Siguron mbështetjen e komunikimit diplomatik dhe teknik me institucionet e Bashkimit Evropian dhe me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;
b) Siguron organizimin e agjendës së takimeve dhe të shkëmbimit të qëndrimeve përkatëse të palëve për çështjet e diskutuara në kuadër të negociatave për çdo kapitull të acquis të Bashkimit Evropian.

SEKRETARIATI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Përbëhet nga:
a) Nëpunës diplomatë
b) Nëpunës Civilë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Funksionet:
a) Bashkërendon dhe mbështet aktivitetin e grupeve ndërinstitucionale të punës;
b) Mbështet hartimin e raportit analitik përfundimtar të harmonizimit të legjislacionit vendas me acquis;
c) Koordinon politikat kombëtare me ato të BE;

GRUPET NDËRINSTITUCIONALE TË PUNËS PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Përbëhet nga:
a) Një zëvendësministër
b) Sekretari i përgjithshëm
Anëtarët e GNP emërohen me urdhër të Kryeministrit.

Funksionet:
a) Analizën e politikave, të legjislacionit, financimit, investimeve, procedurave administrative, ndërveprimit social e të sipërmarrjes private dhe të zbatimit gjyqësor;
b) Përgatitjen e vlerësimit analitik të harmonizimit të legjislacionit vendas me acquis të BE; dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe të raporteve vlerësuese për piketat paraprake dhe piketat përfundimtare për kapitullin përkatës,
d) Përcaktimin e prioritetëve të procesit të përafritim të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE dhe